



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

PPP.nr.116/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Mirjeta Shala, me bashkëpunëtorin profesional Driton Sadiku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energjinë Elektrike Sh.a. (KESco), Bulevardi “Bill Clinton”, nr.5, Ndërtesa e Elektrokosova, Kati II, Prishtinë, kundër debitorit D.Q nga Gjakova, rr... për pagesën e borxhit në shumën prej 2,619.17 euro, sipas dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, duke vendosur sipas propozimit të debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e propozimit përmbarimor të përmbaruesit privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, P.nr.98/19, të datës 13.03.2019, jashtë shqyrtimit gjyqësor me dt.18.08.2020 mori këtë:

AKTVENDIM

I. APROVOHET prapësimi i debitorit D.Q i datës 25.03.2019, si i bazuar.

II. ANULOHET Urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, P.nr.98/19, të datës 13.03.2019, në pjesën që ka të bëjë për periudhën kohore nga data 04.04.2013 deri me datën 22.02.2018, për shumën e përgjithshme të borxhit në lartësi prej 2,173.15 euro dhe prishen të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra nga i njëjti sa i përket këtij borxhi.

A r s y e t i m

Kreditori, Kompania Kosovare për Furnizim me Energjinë Elektrike Sh.a. (KESco), më datën 13.03.2019, ka parashtruar propozim për përmbarim, kundër debitorit D.Q, të përmbaruesit privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, duke kërkuar që në emër të borxhit të faturuar nga data 04.04.2013 deri me datën 07.02.2019, sipas ekstraktit të verifikuar – transaksionet e konsumatorit, debitori t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,619.17 Euro, si dhe shpenzimet e përmbarimit dhe kamatën ligjore.

Përmbaruesi privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, me urdhër përmbarues P.nr.98/19, të datës 13.03.2019, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori urdhrin për lejimin e përmbarimit e ka pranuar me datën 19.08.2019, ndaj të cilit urdhër me datën 26.08.2019, ka parashtruar prapësim ku ndër të tjera ka deklaruar se: propozimin për përmbarim e kundërshtoj për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka shtuar se propozimi për përmbarim nuk është i bazuar dhe ligjor, lartësia e përcaktuar është absolutisht kontestuese, e pa bazë dhe krejtësisht e pa pranueshme. Përndryshe nuk janë krijuar kushtet ligjore që propozimi për përmbarim të kryhet, sepse edhe po të ekzistonte ai borxh është parashkruar-vjetërsuar për shkak se borxhi kërkohet nga data 04.04.2013 deri me datë 07.02.2019, që do të thotë se mbi 90% e borxhit është i parashkruar.

Andaj, gjykatës i propozoi që të hedhet poshtë si i pa rregullt dhe i pa lejuar propozimi i lejuar për përmbarim P.nr.98/19 i datës 13.03.2013.

Ndaj prapësimi të debitorit, me datën 02.09.2019, ka paraqitur përgjigje në prapësimi kreditori, përmes së cilës ka theksuar se: prapësimin e debitorit e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar dhe të paargumentuar me asnjë provë. Kreditori konform rregullave dhe procedurave ligjore ka bërë propozimin për përmbarim, ku propozuesi i propozon përmbaruesit privat përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afariste. Propozimi për përmbarim është bërë për periudhën prej datës 23.03.2016 deri me datë 08.03.2019, duke iu bashkuar në propozim për përmbarim Ekstraktin nga librat afariste, tek kriteri minimal është precizuar borxhi kumulativ jo i ndarë nga faturë për faturë mujore. Me datë 04.07.2018 debitori ka bërë pagesë në vlerë prej 50.00 euro, ku me pagesë vullnetare debitori është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit, ex lege shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe atë konform nenit 368 të LMD-së, çka mund të vërtetohet se i njëjti ka bërë pagesa në drejtim të pagimit të obligimeve të tij, duke përshkruar pagesat e tij vetëm si “Pagesë e energjisë elektrike”, e duke mos paguar për secilën faturë veç e veç, kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit. Kërkesa për prapësim nuk është në harmoni me nenin 69, sipas të cilit prapësimi duhet të mbështetet me provat e duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet. Andaj, gjykatës i propozojmë që të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor i përmbaruesit privat për caktimin e përmbarimit P.nr.98/19 i datës 13.03.2019.

Gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, pas vlerësimit të prapësimi të debitorit, përgjigjes se kreditori, gjeti se:

- prapësimi i debitorit, është i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit në lidhje me parashkrimin e kërkesës dhe gjeti se ky pretendim është i bazuara në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit “*ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi*”, për shumën e përgjithshme të borxhit në lartësi prej 2,173.15 euro, për faturat prej datës 04.04.2013 deri me datën 22.02.2018, për shkak të parashkrimit të kërkesës së kreditorit duke u bazuar në nenin 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.3/3/1978 i aplikueshëm në kohën e krijimit të borxhit e deri me datë 19.12.2012, i cili parashihet që “*Parashkruhen për një vit: kërkesat e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit, për shërbimin e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake*”, e po ashtu i paraparë edhe me nenin 360 të Ligjit Mbi marrëdhëniet e detyrimeve nr.04/L-077, i cili është në fuqi që nga data 20.12.2012, në të cilin theksohet se “*1.Kërkesat të cilat parashkruhen për një (1) vit, 1.1 kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*”, e këtë gjykata e vërtetoj duke vlerësuar propozimin për përmbarim i cili është paraqitur me datën 13.03.2019, dhe me të cilin është kërkuar borxhi në lartësi prej 2,619.17 euro, për periudhën nga data 04.04.2013, deri me datën 07.02.2019, si dhe duke shikuar në ekstraktin e verifikuar nga librat afariste, në emër të debitorit D.Q. Andaj, për këtë pjesë të borxhit, pasi që kemi të bëjmë me shërbimet – heqjen e mbeturinave për nevoja shtëpiake, gjykata vlerësoi se ka kaluar afati i paraparë me dispozitat e lartcekura – afati i parashkrimit, pas kalimit të së cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, për çka vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Për pjesën tjetër të borxhit në lartësi prej 446.02 euro, për periudhën nga data 23.03.2018 deri me datën 07.02.2019 është vendosur me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, me numër

PPP.nr.242/19 të datës 27.08.2020, si në pikën një të dispozitivit të këtij aktvendimi, i cili aktvendim, për pikën një të dispozitivit, është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër Ac.nr.5181/20 të datës 14.04.2021.

Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se me pagesën e bëra nga debitori me datën 04.07.2018, në vlerë prej 50.00 euro, i njëjti e ka ndërprerë afatin e parashkrimit, mirëpo gjykata këtë pretendim e mori si të pabazuar, pasi që gjeti se kjo pagesë është paguar për shpenzimet e kryera muaj për muaj, e përshkruar si “Pagesë e energjisë elektrike!”, andaj vlerësoi se si e tillë nuk e ndërprente parashkrimin e kërkesës së kreditorit. Pasi që e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar për çdo muaj veç e veç parashkruhet në afatin prej 1 (një) viti nga momenti i dorëzimit të faturës. Në çdo faturë është paraparë afati i pagesës dhe nga ai afat fillon të rrjedh parashkrimi. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë. Prandaj nuk mund të konsiderohet se në bazë të lartcekurave ka ardhur deri tek ndërprerja e parashkrimit të borxhit, pasi që në mënyrë decisive në dispozitën e nenit 368 të LMD-së, ligjvënësi ka paraparë se *“Par.1 Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin, Par.2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Gjykata askund në shkresat e lëndës nuk gjeti ndonjë deklaratë të debitorit me të cilën e pranon borxhin e kërkuar nga kreditori, e po ashtu nuk gjeti që i njëjti të ketë bërë ndonjë pagesë në emër të këstit, të kamatës apo dhënie të sigurimit. Andaj gjykata konsideron se pranimi i borxhit nga ana e debitorit duhet të bëhet vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë me deklaratë të debitorit me gojë ose me shkrim, deklarata duhet të jetë e tillë dhe e mjaftueshme për të kuptuar se ajo deklaratë i është drejtuar kreditorit që ka për qëllim pranimin e borxhit, pranimi i borxhit duhet të jetë në atë drejtim që debitori manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet në tërësi apo një pjesë e tij, përveç deklaratës të cilën debitori ia bën kreditorit, pranimi i borxhit mund të bëhet edhe në mënyrë të tërthortë siç është pagesa e këstit, kur për borxhin paguhet një shumë e caktuar në emër të këstit, si dhe mund të bëhet edhe me pagesën e kamatës ose dhënien e mjetit të sigurimit të kërkesës së kreditorit, pra lënia e sendit peng. Këto veprime të debitorit duhet të kenë për qëllim pranimin e borxhit, pra vet debitori është ai që manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet, pranimi i borxhit duhet të jetë mese i qartë, i caktuar i pakushtëzuar dhe duhet të jepet gjatë parashkrimit, andaj bazuar në të cekurat më lartë e në kuptim të nenit 368 të LMD-së, gjykata vlerësoi se pagesat e rregullta nuk e ndërprente parashkrimin, sepse ka dallim esencial në mes të pagesës së këstit dhe pagesave të rregullta, pagesa e kësteve mund të bëhet vetëm pas një marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit për pagesën e një borxhi të caktuar në këste të caktuara, ndërsa pagesat e rregullta bëhen nga ana e debitorit varësisht nga shërbimet e marra nga kreditori, për këtë arsye gjykata vlerësoi se pagimi i faturave të caktuara – pagesat e rregullta nuk paraqesin vullnet të debitorit për pranimin e borxhit paraprak në tërësi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendime tjera të kreditorit dhe arriti në përfundim se ato nuk kishin ndonjë ndikim në sjelljen e këtij aktvendimi.

Andaj nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
PPP.nr.169/21, me datën 05.08.2022

GJYQTARJA
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.